

Procesverbal - Tipi i kontratës - Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i procedurës: “Riparim Hidroizolim dhe mirembajtje e depos Qyteti I nxenesve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV

Punime hidroizolim 45261420-4

Vlera e fondit limit:: 3.725.145,13 (tre milion e shtateqind e njezet e pese mije e njeqind e dyzet pese presje trembedhjete) leke, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar me VKM-në nr.714, datë 24.11.2021 autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;përkatësisht 74 502,9 (shatetdhjete e kater mije e peseqind e dy presje nente).*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomiko-financiar

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025).**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

3. Kapaciteti teknik:

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.4 Kapaciteti teknik:

2.4.1 Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të kryera gjatë tri viteve të fundit (përllogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë punen e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë (të vlefshme), për projektim, të lëshuar nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studim-projektimit, ku duhet të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

- Kategoria 5a – Diga, galeri dhe tunele hidraulike
- Kategoria 5b – Furnizim me ujë dhe kolektorë shkarkimi
- Kategoria 5c – Ujësjellës-kanalizime urbane dhe rurale
- Kategoria 5d – Vepra ujitjeje dhe kullimi, impiante vaditëse, diga deri në 10 m, damba
- Kategoria 5e – Vepra të trajtimit të ujit

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave 28 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit nëndërtim” indryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës). Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumenta

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar

Referuar detyrës së projektimit të administruar në dosjen e procedurës, objekti i kontratës përcakton realizimin e punimeve për “Riaprimin, hidroizolin dhe mirëmbajtjen e depozit të ujit në Qytetin e Nxënësve”. Për shkak të natyrës hidroteknike të këtyre ndërhyrjeve, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë zotërimin e licencave profesionale për kategoritë përkatëse të projektimit, të nevojshme për hartimin e projekteve që lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4.3. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt i kontratës, duhet të disponojnë fuqi punëtore prej të paktën 10 (dhjetë) punonjësish gjatë periudhës Gusht – Tetor 2025.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm për punonjësit e sipërcituar:

- a) Listëpagesat për muajt Gusht – Tetor 2025
- b) Vërtetim nga sigurimet shoqërore mbi deklarin e punonjësve për të njëjtën periudh

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Objekti i kontratës përfshin realizimin e punimeve të specializuara të lidhura me riaktivizimin, hidroizolim dhe mirëmbajtjen e depos të ujit në Qytetin e Nxënësve. Këto ndërhyrje kërkojnë angazhimin e një numri të konsiderueshëm punonjësish teknikë, me qëllim kryerjen e punimeve në afatet e parashikuara dhe në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Proceset e punës që lidhen me izolimin hidroteknik të depos, punimet strukturore, ndërhyrjet në tubacione, përgatitjen e sipërfaqeve, aplikimin e materialeve hidroizoluese, punimet mekanike dhe detyrat ndihmëse kërkojnë ekipe të dedikuara dhe me kapacitet të mjaftueshëm punonjësish.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative,

makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

2.4.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e zbatimit të punimeve, objekt i kontratës, duhet të disponojë stafin mbështetës minimal, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, profili *Konstruksion*
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë për secilin prej punonjësve të sipërcituar dokumentacionin si vijon:

- Kontratë pune të vlefshme
- Diplomë përkatëse e kualifikimit profesional
- Listëpagesat e shoqërisë (formulari E-sig) për periudhën Gusht – Tetor 2025

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Objekti i kontratës përfshin punime hidroteknike dhe konstruktive mbi depot e ujit, të cilat kërkojnë mbikëqyrje profesionale të specializuar. Për realizimin me cilësi dhe siguri të ndërhyrjeve, është e domosdoshme e stafit teknik si **Inxhinier Ndërtimi (Konstruksion)** për vlerësimin dhe kontrollin e ndërhyrjeve strukturore të depozit; **Inxhinier Hidroteknik** për trajtimin e çështjeve hidraulike, presioneve dhe elementeve të furnizimit/shkarkimit të ujit; dhe **Inxhinier Gjeodet** për matjet topografike, nivelimet dhe saktësinë gjeometrike të punimeve.

Ky staf garanton zbatim të sigurt, korrektësi teknike dhe funksionalitet të plotë të veprës pas përfundimit të punimeve.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: Licenca e shoqërisë së vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- **NP-2 A** – Ndërtime civile dhe industriale
- **NP-7 A** – Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi dhe vaditje

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 41, pika 4/a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Punimet e kontratës përfshijnë ndërhyrje konstruktive dhe hidroteknike mbi depot e ujit, si edhe punime lidhëse me rrjetin e furnizimit dhe shkarkimit. Për realizimin e këtyre proceseve është i domosdoshëm operatori të zotërojë licenca zbatimi **NP-2A** – për punimet civile, strukturore dhe rikonstruksionet e elementeve të depozit; **NP-7A** – për punimet hidraulike, tubacionet, pajisjet e ujësjellësit, sistemet e shkarkimit dhe çdo ndërhyrje në infrastrukturë hidroteknike.

Të dyja licencat janë të nevojshme për të garantuar zbatim të sigurt, korrektësi teknike dhe përputhshmëri me natyrën e veprës hidroteknike

Referuar detyrës së projektimit të administruar në dosjen e procedurës, objekti i kontratës përcakton realizimin e punimeve për “Riaprimin, hidroizolim dhe mirëmbajtjen e depozit të ujit në Qytetin e Nxënësve”. Për shkak të natyrës hidroteknike të këtyre ndërhyrjeve, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë zotërimin e licencave profesionale për kategoritë përkatëse të projektimit, të nevojshme për hartimin e projekteve që lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 **(ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes)
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001 : **2015 ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.

ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.

2.4.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë (të vlefshme) për aktivitetin e projektimit, të lëshuar nga institucioni i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licencave profesionale në fushën e studim-projektimit në ndërtim.

Licenca duhet të përfshijë **kategoritë e mëposhtme:**

- **Kategoria 3a** – Objekte civile, industriale dhe turistike prej murature ose skelet betoni të armuar, deri në 5 kate
- **Kategoria 3c** – 1.Objekte me shkallë të lartë vështirësie (konstrukcione betoni të armuar apo metalike) 2.Troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave 28 ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit nëndërtim”indryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës). Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumenta

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në *nenin 41, pika 4/a*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar

Referuar detyrës së projektimit të administruar në dosjen e procedurës, objekti i kontratës përcakton realizimin e punimeve për “Riaprimin, hidroizolimn dhe mirëmbajtjen e depozit të ujit në Qytetin e Nxënësve”. Për shkak të natyrës hidroteknike të këtyre ndërhyrjeve, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë zotërimin e licencave profesionale për kategoritë përkatëse të projektimit, të nevojshme për hartimin e projekteve që lidhen drejtpërdrejt me ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Projektimi i ndërhyrjeve në depos e ujit kërkon ekspertizë të specializuar strukturore dhe konstruktive. Depoja është një vepër e ndërtuar në skelet betoni të armuar dhe përfshin elementë me ngarkesa hidrostatike, çarje, dëmtime të mundshme dhe rrezik infiltrimi, të cilat kërkojnë vlerësim të detajuar inxhinierik.

Kategoria 3a është e domosdoshme sepse punimet lidhen me një objekt civil prej betoni të armuar, që kërkon analizë strukturore dhe detaje konstruktive brenda profilit të saj.

Kategoria 3c është e nevojshme sepse depoja e ujit është vepër me nivel të lartë vështirësie teknike, ngarkesa dinamike dhe rrezik të lartë konstruktiv, si dhe mund të jetë e pozicionuar në terren me stabilitet të kufizuar, që kërkon vlerësim të veçantë të qëndrueshmërisë së saj.

Këto dy kategori garantojnë që projektimi të kryhet nga subjekte me kapacitet të mjaftueshëm teknik dhe profesional për të siguruar siguri strukturore dhe funksionimin e duhur të veprës.

2.4.8. Operatori ekonomik duhet të ketë drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë, si më poshtë, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës:

- 1 (një) Projektues Konstruktore
- 1 (një) Projektues Gjeodet
- 1 (një) Projektues për Vepra Hidraulike

Për secilin prej drejtuesve teknikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtme:

- Kontratë pune të vlefshme
- Diplomë të arsimit të lartë në fushën përkatëse
- Licencë profesionale individuale (sipas kërkesave të MIE)
- CV profesionale
- Librezë pune
- Listëpagesat e shoqërisë (formulari E-sig) për periudhën Gusht – Tetor 2025

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë

19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Projektimi i ndërhyrjeve në depozit e ujit kërkon ekspertizë të specializuar në disa fusha njëkohësisht, pasi depoja përfshin elementë konstruktivë, hidraulikë dhe gjeometrikë. Për këtë arsye është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë projektues të licencuar dhe të përfshirë në licencën e shoqërisë, për të garantuar cilësi dhe siguri teknike të projektit.

Projektuesi Konstruktör është i domosdoshëm për vlerësimin e strukturës mbajtëse të depozit, analizën e dëmtimeve, ndërhyrjet strukturore dhe sigurinë statike. **Projektuesi Gjeodet** nevojitet për matjet topografike, nivelimet, kontrollin e deformimeve dhe garantimin e saktësisë gjeometrike të projektit. **Projektuesi për Vepra Hidraulike** është esencial për analizën hidraulike të depozit, tubacioneve, presioneve, rrjedhjeve dhe elementeve të hidroizolimit.

Prania e këtyre tre profesionistëve siguron hartimin e një projekti të plotë, të sigurt dhe teknikisht korrekt, të domosdoshëm për realizimin e veprës hidroteknike.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.